

V E N D I M
Nr. 146, datë 26.2.1998

PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE

Në mbështetje të neneve 2, 4 dhe 5 të ligjit nr. 7581, datë 7.7.1992, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Punës Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e transportit të udhëtarëve të caktuara në pikën 1 shkronja "a" dhe "b" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 5.8.1996, dhe në pikën 1 shkronja "c" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 598, datë 20.12.1994 "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", ndryshohen si vijon:

a) Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve me autobus në linjat me largësi deri në 9 km, të miratuara sipas kriterëve të neneve 15 dhe 16 të urdhëresës nr.7, datë 17.8.1993 "Për transportin rrugor publik të udhëtarëve dhe bagazheve", caktohen 15 lekë për udhëtarë për një vajtje ose kthim, 330 lekë për një biletë pajtimi mujor për qytetarët dhe 180 lekë për një biletë pajtimi mujor për nxënësit dhe studentët.

b) Tarifat e transportit ndërqytetar automobilistik të udhëtarëve me autobus dhe ato ujqor liqenor) rriten mesatarisht 60 për qind.

c. Tarifat e transportit hekurudhor të udhëtarëve sipas zonave rriten mesatarisht 40 për qind.

2. Në tarifën e transportit të udhëtarëve të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, është përfshirë edhe TVSH-ja.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Financave të përcaktojnë me udhëzim të veçantë çmimet e reja të biletave të transportit hekurudhor sipas zonave dhe të transportit ndërqytetar e ujqor të udhëtarëve, sipas linjave dhe largësive në kilometra si kufi maksimal.

4. Tarifat e transportit të udhëtarëve të miratuara sipas këtij vendimi hyjnë në fuqi më 1 mars 1998.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano